



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Oraovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	11.03.2019
Referencë/a	08 nr. 12/2019
Për/Za/To :	Samedin Hashim Dina nga Rahoveci
Zona Kadastrale:	Rahovec
CC:	
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruçi - Drejtor Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Nga/Od/From/	Sektori për pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Vendim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës së Drejtorisë për punë inspektuese – inspektori i ndërtimtarisë 14 nr. 572 më datë 27.02.2019 në çështjen administrative uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shtetërore të kryer nga ana e Samedin Hashim Dina nga Rahoveci, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (“Gazeta zyrtare e KASK”, nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Samedin Hashim Dina nga Rahoveci me ndërtimin e murit rrethues në gjatësinë prej 20 m skaj rrugës “Kongresi i Manastirit” siç është cekur më afër në skicën e terrenit të hartuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie, ka uzurpuar pjesën e parcelës nr. 1423-0 sipas kulturës rrugë në sip. prej 2 m² Z.K. Rahovec, në emër të P.sh. Kosov. K.K. Rahovec - Rrugët.

II. Uzurpuesi arbitrar Samedin Hashim Dina nga Rahoveci, është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj, dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendim.

III. Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

V. Uzurpimi është kryer në vitin 2019.

A r s y e t i m

Inspektori i ndërtimtarisë i K.K. Rahovec me njoftimin, 14 nr. 275 më datë 27.02.2019 ka njoftuar këtë drejtori se gjatë mbikëqyrjes së rregullt të punës inspektuese ka hasur tek Samedin Hashim Dina në Rahovec duke ndërtuar murin rrethues për çka dyshohet se një pjesë e këtij muri është ndërtuar në rrugën publike, dhe ka kërkuar që kjo të vërtetohet në vendin e ngjarjes.

Drejtorja për kadastrë, gjeodezi dhe pronë – sektori për pronë i K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesë së drejtorisë për punë inspektuese, bashkë me gjeodetin e kësaj drejtorie ka dalur në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit të pjesës së parcelës nr. 1423-0 ka konstatuar se i përmenduri me ndërtimin e murit rrethues ka zgjeruar parcelën e vet nr. 748-0 në dëme të parcelës shtetërore nr. 1423-0, duke bërë uzurpim në sip. prej 2 m².

Pas vërtetimit të gjendjes faktike në vendin e ngjarjes eksperti teknik – gjeometri ka kryer matjen dhe kufizimin e ngastrave në fjalë, përkatësisht ka vendosur dhe shënuar kufijtë dhe ka hartuar skicën e terrenit, në të cilën është pasqyruar qartë pozita, kufiri dhe sip. e uzurpuar.

Gjatë evidentimit dhe shikimit në vend, edhe pse nga personi zyrtar është tentuar të merret në pyetje, kurse i përmenduri nuk ka pranuar që të jepe kurrfarë deklarate lidhur me këtë çështje administrative. më datë 07.03.2019 personi në fjalë, ka ardhur në zyrën e kësaj drejtorie ku përsëri nuk ka dhënë kurrfarë deklarate.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi

shtetërore ("Gazeta Zyrtare e KASK", 46/77 dhe 37/88), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitë të këtij vendimi.


U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i pronës K.K. Rahovec, më 11.03.2019

08 nr. 12/2019

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastra të Kosovës, Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimiit nëpërmjet kësaj drejtorie.

Hartuesi

Jur. i Diplomuar. Nazmi Krasniqi



Drejtori

Jur. Diplomuar. Afrim Oruqi

